



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare individuale
për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025

A.F.

PËRMBAJTJA

FAQE

RAPORTI I AUDITORIT

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

1

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

2

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË GJENDJEN E FONDEVE

3

PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË

4

SHËNIMET E PASQYRAVE FINACIARE

5

A.F.

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Drejtuar menaxhmentit të Federata e Basketbollit të Kosovës

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Federata e Basketbollit të Kosovës, të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2025, pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve në gjendjen e fondeve dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar në atë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Federata e Basketbollit të Kosovës me 31 dhjetor 2025 dhe të performancës financiare dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin financiar që ka përfunduar në atë datë në përputhje me Ligjet aktuale në fuqi.

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA) dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave që janë të ngarkuar me qeverisjen e pasqyrave financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimin e parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Organizatën, ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativë tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe për të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë.

A.F.

Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet tjera dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe. Ne marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezultojnë nga mashtrimi është më i lartë se i atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Përfitojmë njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditim me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Organizatës.
- E vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruara të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushtet që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e organizatës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që organizata të pushojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrës financiare, përfshirë shpalosje nëse pasqyra financiare përfaqëson transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrijë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisje lidhur me qasjen e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.



Armend Osaj – Auditor Ligjor
ACA – Audit & Consulting Associates
Prishtinë, Kosovë
13 Mars, 2026



Federata e Basketbollit të Kosovës
Pasqyra e pozicionit financiar
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

	Shënimet	Më:	Më:
		31/12/2025	31/12/2024
		(në EUR)	(në EUR)
Pasuritë			
<i>Pasuritë qarkulluese:</i>			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3	37,895	44,450
Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera	4	303,597	213,894
Parapagimet dhe të arkëtueshmet tjera		37,036	36,958
Gjithsej pasuritë qarkulluese		378,528	295,302
<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>			
Prona, paisjet dhe impiantet	5	10,828	18,047
Gjithsej pasuritë jo-qarkulluese		10,828	18,047
Gjithsej pasuritë		389,356	313,349
Detyrimet dhe fondet			
<i>Detyrimet afatshkurtëra:</i>			
Llogaritë e pagueshme dhe akrualet	6	742,763	334,885
Të pagueshmet tjera	7	183,569	157,319
Gjithsej detyrimet afatshkurtëra		926,333	492,204
<i>Fondet:</i>			
Gjendja e fondeve		(178,856)	146,050
Teprica/(Mungesa) për vitin		(358,122)	(324,906)
Gjithsej fondet		(536,977)	(178,856)
Gjithsej dhe detyrimet dhe fondet		389,356	313,349

Pasqyrat financiare të përgaditura dhe aprovuara janë nënshkruar më 13 Mars 2026 nga:

Arben Fetahu



Kryetar



Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 12 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Federata e Basketbollit të Kosovës
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

	Shënimet	Më: 31/12/2025	Më: 31/12/2024
Të hyrat nga donatorët	8	1,917,005	1,989,057
Gjithsej të hyrat		1,917,005	1,989,057
Shpenzimet e personelit	9	269,695	231,943
Shpenzimet operative	10	1,998,212	2,074,801
Zhvlerësimi dhe Amortizimi	5	7,219	7,219
Gjithsej shpenzimet		2,275,127	2,313,963
Teprica/(Mungesa) për vitin		(358,122)	(324,906)

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 12 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Federata e Basketbollit të Kosovës
Pasqyra e ndryshimeve në gjendjen e fondeve
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

	Teprica/(Mungesa) e akumulur	Gjithsej
Gjendja më 01 Janar 2024	146,050	146,050
Teprica/(Mungesa) për vitin	(324,906)	(324,906)
Gjendja më 31 Dhjetor 2024	(178,856)	(178,856)
Gjendja më 01 Janar 2025	(178,856)	(178,856)
Teprica/(Mungesa) për vitin	(358,122)	(358,121)
Gjendja më 31 Dhjetor 2025	(536,977)	(536,977)

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 12 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

A.F.

Federata e Basketbollit të Kosovës
Pasqyra e rrjedhës së parasë
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

	Më: 31/12/2025	Më: 31/12/2024
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative:		
Teprica/(Mungesa) për vitin	(358,122)	(324,906)
<i>Rregullimet për:</i>		
Zhvlerësimi	7,219	7,219
Humbja/Fitimi operative para ndryshimeve në kapitalin punues	(350,902)	(317,686)
(Rritja)/zvogelimi në llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera	(89,703)	86,260
(Rritja)/zvogelimi në parapagime	(78)	(23,997)
Rritja/(zvogelimi) në llogaritë e pagueshme	407,878	119,579
Rritja/(zvogelimi) në të pagueshme tjera	26,250	20,580
Paraja neto nga aktivitetet operative	(6,555)	(115,264)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investive:		
Blerja/shitja e pronës, pajisjeve dhe impianteve	-	-
(Rritja)/zvogelimi prej investimeve	-	-
Arketimet nga shitja e pronës, pajisjeve dhe impianteve	-	-
Paraja neto nga aktivitetet investive	-	-
Rritja/zvogëlimi neto në para dhe ekuivalentët e saj	(6,555)	(115,264)
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	44,450	159,714
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	37,895	44,450

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 12 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

D.F.

Federata e Basketbollit të Kosovës

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

1. INFORMATAT GJENERALE

Federata e Basketbollit e Kosovës është asociacion vullnetar i pavarur i klubeve dhe shoqatave të themeluara nga qytetarët, me qëllim të interesave të veçanta dhe të përbashkëta në lëmin e sportit të basketbollit.

Federata e Basketbollit e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Federata) është institucioni më i lartë i sportit të basketbollit në Kosovë për meshkuj dhe femra, që për veprimtari themelore e ka sportin e basketbollit, e organizuar në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit për Sport e Kosovës.

Federata është subjekt juridik dhe vepron në pajtim me Statutin, Statutin dhe Rregulloret e FIBA-s, Ligjin për Sportin e Kosovës dhe Ligjin mbi organizatat jo fitimprurëse.

Federata, si organizatë jo fitimprurëse është e regjistruar në organin përgjegjës dhe e licencuar në Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport të Kosovës (Departamenti i Sportit).

Qëllimet e Federatës janë:

- Masovizimi, zhvillimi cilësor dhe organizimi i basketbollit në Kosovë.
- Sigurimi dhe realizimi i të gjitha kushteve për veprimtarinë e seleksioneve të Federatës.
- Organizimi dhe avancimi profesional i lojtarëve, trajnerëve, gjyqtarëve dhe vëzhguesve të basketbollit.
- Ndhurma organizatave të tjera në promovimin e basketbollit në të gjitha fushëveprimet e sportit të basketbollit, në përputhje me aktet normative.
- Përcaktimi i sistemit të garave për të gjitha kategoritë në nivel të Federatës.
- Pjesëmarrja në manifestime dhe gara ndërkombëtare.
- Mbështetja e zhvillimit të basketbollit në vise të pazhvilluara të Kosovës.
- Organizimi i të gjitha garave në nivel të Kosovës, siç janë: Ligat, Kupa dhe turnetë.
- Organizimi i aktiviteteve profesionale vendore dhe ndërkombëtare.
- Organizimi i kampeve, seminareve, publikimeve profesionale etj.
- Sigurimi i bazës materiale për sportin e basketbollit nëpërmjet marketingut, aktiviteteve ekonomike me qëllim të përmbushjes të kërkesave për veprimtarinë e Federatës
- Përcaktimi i parimeve themelore mbi definimin e statusit të gjithë subjekteve në kuadër të Federatës.
- Pjesëmarrja në punën e KOK-ut dhe asociacioneve të tjera sportive.
- Veprimi kundër përdorimit të dopingut, në përputhje me vendimet e KOK-ut dhe FIBA-s.
- Pjesëmarrja në punën e organizatave të tjera sportive ndërkombëtare, të cilat janë të lidhura me sportin e basketbollit.

Anëtarët e Federatës janë: Klubet e basketbollit (publik edhe private), Shoqata e trajnerëve, Shoqata e gjyqtarëve (organizata profesionale të Federatës), dhe të gjitha klubet dhe shoqatat e tjera të cilat pranohen dhe licencohen në Federatë.

Çdo anëtar i Federatës duhet ta paguajë anëtarësinë vjetore, të cilën e cakton Kuvendi

Organet e Federatës janë:

- Kuvendi
- Bordi
- Kryetari
- Këshilli Mbikëqyrës

D.F.

Federata e Basketbollit të Kosovës

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE DHE POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

2.1. Baza e përgatitjes

2.1.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kontabilitetit në bazë akruale për të hyrat dhe shpenzimet. Bazat e matjes janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në politikat e kontabilitetit të paraqitura më poshtë

2.1.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare për organizatën janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Kostoja historike në përgjithësi bazohet në vlerën e drejtë të vlerës së dhënë në këmbim të të mirave dhe shërbimeve.

2.1.3. Valuta funksionale dhe e prezantimit

Valuta funksionale e organizatës si dhe e prezantimit të pasqyrave financiare është Euro ("EUR"), e cila është valuta kryesore në Republikën e Kosovës që nga 1 janari 2002.

2.1.4. Perdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me ligjet aktuale në fuqi, kërkon që menaxhmenti të bëjë vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shifrat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen mbi baza të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

2.1.5. Parimi i vijueshmërisë

Pasqyra e pozicionit financiar dhe ajo e të ardhurave gjithëpërfshirëse, janë përgatitur mbi parimin e vijueshmërisë, që supozon se organizata do të jetë në gjendje të realizojë pasuritë e saj dhe t'i mbulojë detyrimet, gjatë rrjedhës normale të operimit.

2.2. Politika të rëndësishme kontabël

2.2.1 Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë në dorë, depozitat e mbajtura në bankë dhe investime të tjera afatshkurtra me likuiditet të lartë me maturime origjinale prej tre muajsh ose më pak.

Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valuta të huaja janë të shndërruara në vlerën monetare raportuese duke përdorur shkallën aktuale të këmbimit të transaksionit. Fitimi dhe humbja si rezultat i transaksioneve nga shëndërimi në normat e këmbimit të fund-vitit të mjeteve monetare dhe detyrimeve në valutat e huaja janë të njohura në pasqyrën e të ardhurave.

D.F.

Federata e Basketbollit të Kosovës

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

2.2.2 Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera

Të arkëtueshmet

Të arkëtueshmet fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas mbarten me kosto minus provizionet, nëse ka. Një provizion njihet kur ka dëshmi objektive që organizata nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumatat e duhura sipas kushteve fillestare të të arkëtueshmeve.

2.2.3 Parapagimet dhe të arkëtueshmet tjera

Në llogarinë e parapagimeve dhe të arkëtueshmeve tjera përfshihen parapagimet dhe pasuritë e tjera qarkulluese. Parapagimet mbahen me kosto minus provizioni nëse ka. Një parapagim klasifikohet si atfatgjatë kur mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin pritet të merren pas një viti.

2.2.4 Prona, pajisjet dhe impiantet

Prona, pajisjet dhe impiantet janë matur me kosto historike minus zhvlerësimi i akumuluar dhe çdo humbje e akumuluar nga dëmtimi (rënia në vlerë). Zhvlerësimi ngarkohet në mënyrë që të ndahet kosto e pasurive minus vlera e tyre e mbetur përgjatë jetës së përdorimit të parashikuar, duke përdorur metodën lineare. Normat vjetore të mëposhtme janë përdorur për zhvlerësimin e pronës, impiantëve dhe pajisjeve:

Ndërtesat dhe struktura ndërtimore	5 %
Impiantet dhe makineria e rëndë	10 %
Pajisjet, mobilieritë, kompjuterët	20 %

Nëse ka një tregues se ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në normën e zhvlerësimit, jetën e dobishme ose vlerën e mbetur të një pasurie, zhvlerësimi i kësaj pasurie rishikohet në mënyrë prospektive për të pasqyruar pritshmëritë e reja.

2.2.5 Dëmtimi (rënia në vlerë) i pasurive

Në çdo datë të raportimit, prona, pajisjet dhe impiantet, pasuritë e tjera të paprekshme dhe investimet në pjesëmarrje rishikohen për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues se këto pasuri kanë pësuar ndonjë dëmtim, përkatësisht ndonjë humbje nga rënia në vlerë. Nëse ka një tregues për rënie të mundshme, shumata e rikuperueshme e çdo pasurie të prekur (ose grup pasurish të ngjashme) vlerësohet dhe krahasohet me vlerën e saj kontabël. Në qoftë se shumata e vlerësuar e rikuperueshme është më e ulët, vlera kontabël ulet deri në shumën që vlerësohet se do të merret, ndërsa shumata e dëmtimit (humbja nga rënia në vlerë) njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Fitimi ose humbja që paraqitet me rastin e shitjes ose nxjerrjes nga përdorimi i një pasurie përcaktohet si diferencë midis të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël neto të një pasurie dhe si rrjedhojë njihet si fitim ose humbje në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

A.F.

Federata e Basketbollit të Kosovës

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

2.2.6 Llogaritë e pagueshme dhe akrualet

Shumat e pagueshme janë matur në kosto që është vlera e drejtë e shumës për t'u paguar në të ardhmen për mallërat dhe shërbimet që janë marrë. Llogaritë e pagueshme tregtare janë detyrime në bazë të afateve normale të kreditimit dhe nuk bartin interes. Të pagueshmet të shprehura në valutë të huaj prezentohen në valutën Euro duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimet ose humbjet e këmbimit valutor janë të përfshira në të ardhurat e tjera apo shpenzimet e tjera.

2.2.7 Njohja e te hyrave

Të hyrat njihen si të ardhura në periudhën kur ndodhin. Në fund të vitit sasia e tepërt e të hyrave krahas shpenzimeve trajtohen si bilanc i bartur në periudhën e ardhshme.

2.2.8 Grantet

Grantet e Qeverisë njihen në fitim ose humbje në baza sistematike përgjatë periudhës në të cilën Organizata i njej si shpenzime kostot përkatëse për të cilat grantet janë destinuar për kompenzim. Në mënyrë specifike grantet e Qeverisë, për të cilat kushti primar është që Organizata duhet të i përfitoj, konstruktoj apo të i njej pasuritë jo-qarkulluese si të hyra të shtyra në pasqyrën e pozitës financiare dhe të transferohen në fitim apo humbje në baza sistematike dhe racionale përgjatë jetës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

Grantet janë njohur vetëm kur ka siguri të arsyeshme se:

- Organizata do të përmbushë të gjitha kushtet e bashkangjitura atyre; dhe
- Grantet do të pranohen.

Grantet operative janë njohur si e hyrë përgjatë periudhës së nevojshme për ti lidhur ato me kostot, për të cilat janë menduar të kompensohen, në bazë sistematike. Grantet e shënuara për përvetësimin e pasurive janë shtyrë dhe njohur si e hyrë përgjatë kohës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

2.2.9 Shpenzimet

Shpenzimet janë njohur në periudhën përkatëse kur kanë ndodhur.

2.2.10 Provizionet dhe detyrimet e papritura (kontingjente)

Detyrimet e papritura nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato janë shpalosur vetëm nëse mundësia e rrjedhës së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Aseti kontingjent nuk është njohur në pasqyrat financiare por është shpalosur kur rrjedhja e përfitimeve ekonomike është e mundshme.

Federata e Basketbollit të Kosovës

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

3. PARAJA DHE EKVIVALENTËT E PARASË

<u>Paraja dhe ekuivalentët e parasë</u>	<u>31/12/2025</u>	<u>31/12/2024</u>
Paraja në bankë	37,678	44,177
Paraja në arkë	217	274
Gjithsej	37,895	44,450

4. LLOGARITË E ARKËTUESHME DHE TE TJERA

<u>Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera</u>	<u>31/12/2025</u>	<u>31/12/2024</u>
Të hyrat nga klubet	278,258	184,107
SHB	24,000	24,000
Reload	1,339	5,000
MKRS	-	787
Gjithsej	303,597	213,894

Federata e Basketbollit të Kosovës

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

5. PRONA, PAISJET DHE IMPIANTET

	Pajisjet sportive	Gjithsej
Kosto		
Balanca më 31 dhjetor 2023	36,094	36,094
Shtesa	-	-
Heqjet	-	-
Balanca më 31 dhjetor 2024	36,094	36,094
Shtesa	-	-
Heqjet	-	-
Balanca më 31 dhjetor 2025	36,094	36,094
Zhvlerësimi		
Balanca më 31 dhjetor 2023	10,828	10,828
Zhvlerësimi për vitin	7,219	7,219
Heqjet	-	-
Balanca më 31 dhjetor 2024	18,047	18,047
Zhvlerësimi për vitin	7,219	7,219
Heqjet	-	-
Balanca më 31 dhjetor 2025	25,266	25,266
Neto vlera		
Balanca më 31 dhjetor 2024	18,047	18,047
Balanca më 31 dhjetor 2025	10,828	10,828

Federata e Basketbollit të Kosovës

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

6. LLOGARITË E PAGUESHME DHE AKRUALET

<u>Llogaritë e pagueshme dhe akrualet</u>	<u>31/12/2025</u>	<u>31/12/2024</u>
Shpenzimet akruale	139,876	56,836
FIBA	115,374	1,600
Detyrimet tjera	74,675	54,580
Marigona Tower SH.P.K.	73,662	71,530
Besim Dina B.I.	70,400	30,800
Detyrimet tjera ndaj furnitoreve	53,182	6,956
Florent Gorqaj B.I.	30,554	22,800
Cooperation Architecture	24,216	-
Ylli Pashtriku shpk	21,962	-
Asociation Loyola - Gymnasium	9,900	-
The Danish Basketball Association	8,439	8,439
Auto Mita shpk	8,258	2,982
Fehmi Xharavina B.I.	8,100	-
Kabashi Holding shpk	7,854	-
Alma Zhubi BI	7,285	-
Apolonia shpk	6,975	-
Sporting	5,617	600
Neon Art House SH.P.K.	5,366	369
Garden Downtown L.L.C.	4,132	-
Federata Shqiptare e Basketbollit	3,270	3,270
TRAVEL ON L.L.C.	2,929	8,675
CHE BAR LOUNGE SH.P.K.	2,150	-
DUVA SH.P.K.	1,947	-
Fiba Europe E.V	1,600	-
FIBA Europe Properties	1,500	3,500
Sarajeva Steak House SH.P.K.	1,397	800
Che bar lounge Residence	1,080	-
Base Advertising Agency	1,003	-
Sport Tex sh.p.k.	566	566
Tiffany	383	-
CITY HOTEL SH.P.K.	180	180
Data Project Electronics	50	50
N.SH. ANISA COM	-	6,999
UBO CONSULTING SH.P.K.	-	6,635
Golden Taxi	-	6,548
Pallati i Rinise SH.A.	-	6,487
IP-Kos	-	662
IPKO Telecommunications L.L.C.	-	223
KESCO	-	146
INTERNATIONAL SECURITY SH.P.K.	-	80
Mada Group Shpk	-	1
Global CT Digital Kosovo SH.P.K.	-	1
Nën total	693,882	302,316
Huazimet e marra	43,250	28,250
Starcad	5,631	4,319
Gjithsej	742,763	334,885

AF-

Federata e Basketbollit të Kosovës

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

7. TË PAGUESHMET TJERA

<u>Të pagueshmet tjera</u>	<u>31/12/2025</u>	<u>31/12/2024</u>
Detyrimi ndaj kontributeve pensionale	85,904	79,090
Detyrimi ndaj tatimit te mbajtur ne burim	97,386	77,949
Detyrimi ndaj punetoreve	280	280
Gjithsej	183,569	157,319

8. TË HYRAT

<u>Te hyrat nga donacionet</u>	<u>31/12/2025</u>	<u>31/12/2024</u>
Të hyrat nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	571,382	241,950
<i>Të hyrat nga FIBA:</i>		
Youth Development Fund	39,908	56,000
Youth Participation Fee	-	40,000
Regjistrim i lojtareve	-	21,002
Her World Her Rules	18,000	25,000
Alley Oop	-	25,000
Mbeshtetje financiare për organizimet	164,264	129,415
Gjithsej te hyrat	222,172	296,417
Nën total (I)	793,554	538,367
<i>Te hyrat nga sponsorët</i>		
Te hyrat nga Art Motion	250,000	332,500
Te hyrat nga ProCredit Bank	225,000	225,000
Te hyrat nga TEB	120,000	150,000
Te hyrat nga Ventius	-	100,000
Te hyrat nga AutoMita	38,500	51,000
Te hyrat nga Kujtesa	-	50,000
Te hyrat nga Bluechip internati	-	40,000
Te hyrat nga Klan Kosova	-	30,000
Te hyrat nga Vitaminka	-	12,000
Te hyrat nga Tregtia shpk	-	10,000
Te hyrat Ndermarja e re e Amort	-	10,000
Te hyrat nga Uje Rugove SHPK	11,000	8,000
Te hyrat nga Devolli Logistic	-	7,500
Te hyrat nga Albi Commerce	40,000	-
Te hyrat nga ERASMUS+	85,249	-
Te hyrat nga Illyria Life SHA	37,500	-
Te hyrat nga SAVA	37,500	-
Te hyrat e Pritshme nga Klubet	9,027	-
Te hyrat nga shtetet	42,082	-

Federata e Basketbollit të Kosovës

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

Te hyrat nga shitja e biletave	2,157	-
Te hyrat nga Shita & Associates	-	-
Te hyrat Bipharm	-	-
Gjithsej Të hyrat nga sponsoret	898,015	1,026,000
Nën total (II)	898,015	1,026,000
Te hyrat nga Aktivitetet		
Të hyrat nga aktivitetet	214,115	397,340
Të hyra nga KOK	4,461	-
Komuna e Prishtines	-	10,128
Të tjera	6,860	17,223
Gjithsej të hyrat nga aktivitetet	225,436	424,690
Nën total (III)	225,436	424,690
Gjithsej të hyrat I+II+III	1,917,005	1,989,057

9. SHPENZIMET E PERSONELIT

Shpenzimet e personelit	31/12/2025	31/12/2024
Pagat Bruto	254,912	219,859
Kontributet Pensionale	14,783	12,084
Gjithsej	269,695	231,943

Federata e Basketbollit të Kosovës

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

10. SHPENZIMET OPERATIVE

Shpenzime operative	31/12/2025	31/12/2024
Shpenzimet për paga dhe meditime për trajnerë, komisione në FBK, aktivitete tjera (Liga Unike, Qendra Nacionale, Përfaqësueset e Kosovës, YDF, Junior NBA, Kurset dhe Klinikat për Gjyqtarë dhe Trajnerë,	347,766	346,673
Shpenzimet e udhëtimit (Liga Unike, Qendra Nacionale, Përfaqësueset e Kosovës, YDF, Junior NBA, Kurset dhe Kliikat për Gjyqtarë dhe Trajnerë, Kampionati Evropian, aktivitet)	283,233	395,515
Shpenzimet për paga të personave zyrtarë të ndeshjes	221,227	237,963
Produksion	189,459	97,467
LED, Rekuizita, Brendime	158,901	135,475
Marketing (Konform Rregullorës për agjetë/kompanitë e kontraktuara për sponsorizim të FBK-së dhe tjera)	84,910	54,770
Shpërblimet (Edicionionet garuese, Liga Unike)	83,000	67,500
Shpenzime të tjera	80,660	75,685
Ushqim për lojtarët dhe stafin (Përfaqësueset, Qendra Nacionale Nacionale, Organizimet Ndërkombëtare, Organizimet Kombëtare, Aktivitete tjera)	75,942	89,408
Shpenzime për pajisje zyrtare dhe veshje sportive për aktivitete dhe Përfaqësuese	61,858	68,190
FIBA Contribution	60,112	56,000
Shpenzimet e transportit për të gjitha aktivitetet e FBK-së	40,389	55,711
Makina me qira	37,680	37,343
Shpenzimet e qirasë	37,319	25,482
Regjistrimi I lojtarëve të huaj FIBA	35,204	33,704
FIBA License Fee	30,367	26,352
FIBA Registration Fee	26,735	-
Fondi për të drejtat televizive	24,000	24,000
Konsulencë	23,224	66,622
Shpenzimet për zyre	20,445	22,357
Kampanja	18,533	10,473
Shërbime mjekësore (Përfaqësueset, Kampionate Evropiane, YDF, Qendra Nacionale, etj)	16,378	14,713
Participim	14,400	1,600
FIBA Prize Money	9,495	74,282
Donacion	4,800	6,300
Sigurime tjera gjatë organizimeve	4,540	5,450
Shpenzimet e sallës	3,231	8,413
Shpenzimet e telekomunikimit	2,666	3,759
Shpenzime komunale	1,740	3,321
Medikamente	-	143
After movie	-	20,526
Subvencione për klube	-	9,000
Mirëmbajtje dhe rregullime	-	604
Gjithsej	1,998,212	2,074,801

A.F.

Federata e Basketbollit të Kosovës

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

11 KONTIGJENCAT DHE ZOTIMET

11.1. Çështjet ligjore

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2025 organizata nuk ka ndonjë detyrim kontingjent që kërkon shpalosje në pasqyrat financiare të saj.

12 NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka ngjarje domethënëse pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullime ose shpalosje në pasqyrat financiare.

A.F.